



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV.-14-3640

Parashtruesi i ankesës:

R. K, Komuna e Malishevës, (i përfaqësuar nga a...B I A, Prishtinë).

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore “N M” - Malishevë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Agim Ramadani”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Manushe Karaçi më 21 prill 2020, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimet e Autoritetit të Likuidimit PRZ008-0565 dhe PRZ008-0566 të datës 23 dhjetor 2013 vërtetohen si të drejtë dhe të bazuar në ligj.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 25 prill 2014 Dhoma e Posaçme ka pranuar ankesë nga parashtruesi i ankesës kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, me të cilën kërkon tri pagat e papaguara për periudhën e pasaktësuar në shumë prej 360.00€ nga Ndërmarrja Shoqërore “NB M” - Malishevë, dhe shpenzimet e procedurës.

Kësaj ankese parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- Kopjen e vendimit të AKP-së sipas kërkesës PRZ008-0565 të datës 23 dhjetor 2013, për

- refuzimin e kërkesës së paraqitur nga Parashtruesi i ankesës;*
- *Kopjen e vendimit të AKP-së sipas kërkesës PRZ008-0566 të datës 23 dhjetor 2013, për refuzimin e kërkesës së paraqitur nga Parashtruesi i ankesës;*
 - *Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 6 nëntor 2009.*

Parashtruesi i ankesës kishte paraqitur kërkesë të afatshme pranë Autoritetit të Likuidimit më 9 gusht 2013, për tri pagat e papaguara për periudhën e pasaktësuar në shumë prej 360.00€ nga Ndërmarrja Shoqërore “N M” - Malishevë, dhe shpenzimet e procedurës.

Më 23 dhjetor 2013 Agjencia Kosovare e Privatizimit nxjerr vendimin sipas kërkesës PRZ008-0565, me të cilin refuzon kërkesën e parashtruesit të ankesës si të pavlefshme.

Në vendim AKP-ja thekson se bazuar në të dhënat e NSH-së, parashtruesit iu është ndërprerë marrëdhënia e punës më datën e privatizimit të NSH-së pra më 4 nëntor 2009 dhe se çdo pretendim në lidhje me marrëdhënien e punës me NSH-në ankuesi mund t’i referohet vetëm periudhës pas kësaj date.

AKP-ja e refuzon kërkesën si të pavlefshme duke ju referuar Nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në dhe Nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, që parashikon që ‘pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet’.

Sipas AKP-së për të ndërprerë parashkrimin kërkesa do të duhej të paraqitej në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur parashtruesit i ka lindur e drejta për të kërkuar dëmshpërblim si pasojë e ndërprerjes së parakohshme të kontratës, pra tre vite nga data 4 nëntor 2009.

AKP-ja gjithashtu thekson se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë të parashtrimit të ndonjë ankese apo kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent para përfundimit të periudhës së parashkrimit.

Gjykata vëren se Parashtruesi i ankesës kishte paraqitur edhe një kërkesë tjetër të afatshme pranë Autoritetit të Likuidimit më 9 gusht 2013, për pagat e papaguara në shumë prej 4,114 euro për periudhën 23 mars 1992 – 30 qershor 1999 nga Ndërmarrja Shoqërore “NB M” - Malishevë, dhe shpenzimet e procedurës.

Më 23 dhjetor 2013 Agjencia Kosovare e Privatizimit nxjerr vendimin sipas kërkesës PRZ008-0566, me të cilin refuzon kërkesën e parashtruesit të ankesës si të pavlefshme.

AKP-ja e refuzon kërkesën si të pavlefshme duke ju referuar Nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në dhe Nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, që parashikon që ‘pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet’.

Sipas AKP-së për të ndërprerë parashkrimin kërkesa do të duhej të paraqitej në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur parashtruesit i ka lindur e drejta për të kërkuar dëmshpërblim si pasojë e ndërprerjes së kontratës, pra tre vite nga data 23 mars 1992.

Tutje, AKP-ja në vendimin e saj thekson se njohja e borxhit nga ana e Këshillit të Punëtorëve të NSH-së më 11 gusht 2005 bëri të mundur që të rilind e drejta për të kërkuar pagat e papaguara dhe periudha e parashkrimit të rrjedh përsëri nga e para (neni 392.2 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore nr. 29/1978 të publikuar në Gazetën Zyrtare të ish RSFJ-së). Si rrjedhojë, e drejta për të kërkuar pagat e papaguara rilindi më 11 gusht 2005 dhe përfundoi më 11 gusht 2008.

AKP-ja thekson se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë të parashtrimit të ndonjë ankese apo kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent para përfundimit të periudhës së parashkrimit.

Më 11 mars 2020 AKP-ja dorëzon mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 25 prill 2014 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ008-0566 të NSH “NB M” - Malishevë (në likuidim).

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ008-05656 të datës 23 dhjetor 2013.

Më 20 janar 2020, Zyrtarja për Financa i ka dërguar Vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore për paditësin duke kërkuar pagesën e taksave gjyqësore ashtu siç janë dhënë në procedurë ose të paraqesë prova që bën pjesë në kategorinë e të përjashtuarve nga kjo pagesë. Gjykata e njoftoi paditësin mbi pasojat e mospagimit të kësaj pagese specifike.

Më 21 janar 2020, paditësi është shërbyer me Vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore, që të paraqes prova mbi pagesën efektive të taksave gjyqësore si parashikohet nga Udhëzimi Administrativ, ose të paraqes provat që pala të cilën ai e përfaqëson është i përjashtuar nga pagesa e taksave efektive si parashikohet nga Udhëzimi Administrativ.

Më 4 shkurt 2020 paditësi e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 euro.

Arsyetimi Ligjor

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Nr. 06/L-086).

Ankesa e parashtruesit refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimet e Autoritetit të Likuidimit

PRZ008-0565 i datës 23 dhjetor 2013 dhe PRZ008-0566 i datës 23 dhjetor 2013 vërtetohen si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Interpretimi i mësipërm është në linjë me jurisprudencën e qëndrueshme të Dhomës së Posaçme. *[Shih, për shembull lëndët: AC-I-15-0253 të datës 27 shtator 2016, AC-I-15-0029 të datës 8 qershor 2017, AC-I-15-0051 të datës 27 korrik 2017, AC-I-16-0187 të datës 23 shkurt 2017 etj.]*.

Paditësi ka kërkuar tri pagat e papaguara për periudhën e pasaktësuar në shumë prej 360.00€ nga Ndërmarrja Shoqërore “N.. M” - Malishevë, dhe shpenzimet e procedurës.

Parashtruesi i ankesës kishte paraqitur edhe një kërkesë tjetër të afatshme pranë Autoritetit të Likuidimit më 9 gusht 2013, për papaguara në shumë prej 4,114 euro për periudhën 23 mars 1992 – 30 qershor 1999 nga Ndërmarrja Shoqërore “N.. ” - Malishevë, dhe shpenzimet e procedurës.

Afati për dorëzimin e kërkesëpadisë nr. PRZ008-0565, lidhur me pagat e papaguara ka skaduar më 4 nëntor 2012, ndërsa paditësi i kërkoi këto paga vetëm pranë Autoritetit të Likuidimit më 9 gusht 2013.

Afati kohor për të cilën paditësi kishte kërkuar pagat e papaguara ka filluar të rrjedhë më 4 nëntor 2009. Paditësi këto shuma nuk i kishte kërkuar asnjëherë më parë nga e paditura me padi gjyqësore të parashtruar pranë ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent.

Lidhur me kërkesën e parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ008-0566, paditësi është dashur të kërkonte pagat e papaguara brenda tre viteve nga data 23 mars 1992.

Gjykata vlerëson se kjo e drejtë është parashkruar më 23 mars 1995 ngase paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë të parashtrimit të ndonjë ankese apo kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent para përfundimit të periudhës së parashkrimit.

Gjykata gjithashtu e ka parasysh njohjen e borxhit nga ana e Këshillit të Punëtorëve të NSH-së më 11 gusht 2005 që bëri të mundur të rilind e drejta për të kërkuar pagat e papaguara dhe periudha e parashkrimit të rrjedh përsëri nga e para (neni 392.2 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyimore nr. 29/1978 të publikuar në Gazetën Zyrtare të ish RSFJ-së). Si rrjedhojë, e drejta për të kërkuar pagat e papaguara rilindi më 11 gusht 2005 dhe përfundoi më 11 gusht 2008.

Paditësi sërish ka dështuar të paraqesë provë të parashtrimit të ndonjë ankese apo kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent para përfundimit të periudhës së parashkrimit, respektivisht para datës 11 gusht 2008.

Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034 parasheh që “...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ...kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;”

Sipas Nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar “pagesa e pagës apo rrogës, apo çdo lloj tjetër kërkesë e punëtorit që buron nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”.

Për më tepër, Neni 137 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 gjithashtu e parasheh afatin e njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Ndaj ankuesit nuk caktohet taksë gjyqësore ngase të njëjtën e ka paguar më 4 shkurt 2020, në shumë prej 20 euro.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

GJYQTARJA,
Manushe Karaçi